# DËSHMI ARKIVI

**A-460478**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Spektakël në “Selman Stërmasi”, Tirana dhe Elbasani ndajnë pikët në një barazim me katër gola |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/20/spektakel-ne-selman-stermasi-tirana-dhe-elbasani-ndajne-piket-ne-nje-barazim-me-kater-gola/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 16:04:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 20 shtator 2026, 15:58:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 20 shtator 2026, 15:57:00 UTC → 20 shtator 2026, 15:59:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a53cff4a3d75cc6f028a64ed8d12892d464fd6fbe9ee0efd431a70f621d039e3` |
| TEKSTI | `c62dd6f9f342ddd5a2011d56ca261434fb114cdcead60921bf150581c54b7859` |
| PAMJA | `90cf70eed10c8fdd59cafe16dd9988147eff80404a0880c3659aacb6d5026b56` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0ed9aa153b8068ef00dfcbf2bb95707f479959303f9018976713c161572a7f84` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `27cd3d5362ad8606db4b4a4bb83953e8ab924c30f9fa24532364779df926f41e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0ed9aa153b8068ef00dfcbf2bb95707f479959303f9018976713c161572a7f84`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Spektakël në "Selman Stërmasi", Tirana dhe Elbasani ndajnë pikët në një barazim me katër gola

20/09/2026 17:58



**Tirana dhe Elbasani kanë ndarë nga një pikë në javën e pestë të Superiores, pas një ndeshjeje me katër gola në "Selman Stërmasi".**

Përballja përfundoi 2-2, me Redon Xhixhën që ishte protagonist absolut për bardheblutë, duke shënuar të dy golat e skuadrës së tij.

Ndeshja u zhvillua pa praninë e tifozëve, pasi Tirana nuk arriti të konvertonte në kohë me gjobë pjesën e mbetur të dënimit.

Miqtë e nisën më mirë takimin dhe gjetën golin e parë në minutën e 23-të. Nikaj depërtoi në zonë dhe pasoi në qendër, ndërsa Ndong, në përpjekje për të larguar topin, e devijoi atë në portën e tij.

Tirana reagoi shpejt dhe vetëm shtatë minuta më vonë erdhi barazimi. Kish harkoi nga e djathta dhe Redon Xhixha, i vetëm në zonë, goditi me kokë duke mposhtur Aleksovskin për 1-1.

Elbasani nuk u tremb dhe në minutën e 37-të riktheu avantazhin. Mazari shmangu pozicionin jashtë loje, kaloi edhe Bekajn dhe nga e majta dërgoi topin në rrjetë.

Pjesa e parë u mbyll me avantazhin 2-1 të Elbasanit.

Tirana e nisi pjesën e dytë në kërkim të golit dhe në minutën e 54-t gjeti atë që kërkonte.

Një aksion i bukur në krahun e djathtë përfundoi me pasimin e Ilievskit për Xhixhën, i cili nuk gaboi përballë portës dhe shënoi golin e dytë personal, duke vendosur rezultatin në 2-2.

Pas barazimit, bardheblutë patën disa mundësi të mira për të përmbysur ndeshjen.

Rasti më i madh për Tiranën erdhi në minutën e 78-të. Xhixha ishte shumë pranë tripletës, teksa goditja e tij nga kufijtë e zonës u ndal nga shtylla.

Edhe Elbasani pati mundësi në minutat e fundit, por asnjëra skuadër nuk arriti të gjente golin e fitores.

Në fund, Tirana dhe Elbasani ndanë pikët me rezultatin 2-2.

**Tirana 2-2 Elbasani**

*30' Xhixha, 54' Xhixha / 23' Ndong (autogol), 37' Mazari*

**Top Channel**


## SPORT • KRYESORE



Live Atletico-Real/ Ekipi i Simeones merr derbin në dorë, David shënon dhe golin e dytë (Video)



Kthehet Interi i çmendur, përmbysja shndërrohet në markën e Cristian Chivut



Milan pret Gonçalo Ramos, por golat i shënojnë ish lojtarët e tij. Zhgënjen vetëm...Leao



Dejvi Bregu spikat edhe larg Dinamos, gol dhe asist për të në futbollin arab(VIDEO)



Barcelona, Raphinha feston rinovimin e kontratës duke shkruar historinë, braziliani kalon Messin

## ME TË LEXUARAT

Lamine Yamal hapet: Më keni zili për paratë, por do të doja të isha në vendin tuaj

Borussia Dortmund, shokohet Nico Kovac, mëson gjatë intervistës për ndarjen nga jeta të ish asistentit të tij

Premier League/ Manchester City është i pandalshëm, "Qytetarët" arrijnë fitoren e pestë radhazi, tre pikë edhe për Liverpoolin

20/09 16:59

Jimenez i përgjigjet Gilmour, Fiorentina frenon Napolin në barazimin 1-1

20/09 16:42

Pedro Acosta shkruan historinë, triumfon për herë të parë në MotoGP

20/09 16:39

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top News – Trump do t'i ndryshojë emrin IA / 'Duhet ta quajmë Inteligjencë Supreme ose Ekstreme'



Top Channel/ 'Toyota Auris' përfshihet nga flakët pranë kthesës së Picarit, shkrumbohet e gjitha



Top News – Trump kthehet urgjentisht në zyrë / SHBA lëshon alarmin: Përshkallëzim në Arabinë Saudite



Top News – Haga nis kompensimin e viktimave…Pa pritur vendimin e apelit, reagime në Kosovë



Top Channel/ Zjarr në Babicë të Vlorës, flakët rrezikojnë një banesë. Ndërhyjnë forcat zjarrfikëse



Top News – Studentët kundër vendimit të Speciales/Protestë e madhe në Prishtinë, thirrje për unitet

### Lajme
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

### Bota
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

### Sport
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

### Pop News
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

### Programe
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

### Top Channel
- Rreth Top Channel
- Topin e kam unë – Apliko tani!
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.